



## P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 18.06.2020, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimi më lejoni të përshëndes, nënkyryetarin **Fatmir Iska**, drejtor të drejtoreve, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

## R E N D D I T E

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore ( KAB ) 2021 – 2023,
3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për taksa komunale,
4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për faljen e borxhit për taksë komunale,
5. Të ndryshme .

**Kryesuesi** – E vë në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanim e shtë aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar** – A ka dikush diçka rrëth procesverbalit.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përshendetje për juve, këshilltarë kolegë, drejtorë të drejtoreve dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Në procesverbal unë kam vërejtje, ka gabime teknike që duhet me bë një përmirësim ne faqe 2 pikë e 3, ka qenë shqyrtimi i vendimit për dhëni e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë, fjala ka qenë për parcelën në Malësi të Vogël ( Radoste), te fjalimi im sipërfaqja e shtë gabim 7.69 m<sup>2</sup> e që duhet të jetë 7.69 ari pra i njëjtë gabim e shtë përsëritur edhe më poshtë, po ashtu edhe te fjalimi i drejtorit Afrim Oruqi. Unë mendoj që gabimi e shtë në sipërfaqe pra gabim teknik dhe duhet të përmirësohet. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Cena, atëherë meqë nuk kemi tjetër, e qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pikë e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore ( KAB ) 2021-2023.**

**Afrim Limani** – I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, të nderuar kolegë këshilltarë. Me datë 15.05.2020 në adresën e Komunës ka ardh qarkorja e parë buxhetore për vitin 2021-2023 dhe dihet që në kuadër të kësaj qarkoreje caktohen edhe limitet buxhetore se sa do të ketë buxhet Komuna e Rahovecit për vitin 2021, kuptohet në bazë të një formule të përgjithshme që i ka kriteret e veta dhe caktohet pjesa se sa na takon buxheti i komunës tonë. Për dallim prej viteve tjera, për vitin 2021 do të kemi një zbritje të buxhetit si rezultat i formulës së përgjithshme që e shtë zbritur buxheti sepse e shtë një departament në kuadër të Ministrisë së Financave i cili merret me projeksione edhe me vlerësimë ekonomike dhe ka konstatuar se buxheti në vitin 2021 në nivel qendror do të jetë më i vogël afersisht për 6 milion euro, kështu që ky zvogëlim ka reflektuar edhe në komunën tonë dhe kemi një zvogëlim të buxhetit në raport me vitin e kaluar

prej në total 186,996 euro. Buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2021 në total është 14,548,823 euro, do të thotë me një zvogëlim në raport me vitin e kaluar prej 186,996 euro, pra vet pjesa e grantit ka pësuar një zvogëlim prej 186,000 euro dhe atë granti i përgjithshëm me një ndryshim negativ prej 173,251 euro, granti i arsimt me një zvogëlim prej 75,214 euro ndërsa granti për shëndetësi ka një rritje prej 61,345 euro, që në total plus minus ndryshimi është prej 186,966 euro. Prandaj ne si kuvendë duhet të aprovojmë këtë qarkore buxhetore me këto limite pra këto tavane buxhetore të cilat janë të përcaktuara në qarkoren e parë buxhetore. Ne si drejtori për Financa dhe Buxhet e kemi bërë edhe një analizë të buxhetit në bazë të kategorive ekonomike edhe pse ata duhet ta presin në qarkoren e dytë buxhetore ku caktohen tavanet buxhetore atëherë në bazë të një analize kemi ardh në përfundim se si indikator kryesor është ligji i pagave i cili reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë në përcaktimin e buxhetit në kuadër të kategorive ekonomike. Nëse zbatohet ligji i pagave atëherë kategoritë ekonomike përafërsisht buxheti do të jetë kështu: pagat dhe mëditjet 9,112,000 euro, mallra dhe shërbime 1,594,330 euro, shërbime komunal 280,000 euro, subvencione dhe transfere 311,000 euro dhe investime kapitale 3,250,000 euro. Por, nëse eventualisht nuk zbatohet ligji i pagave atëherë pozicioni i buxhetit në kategori do të jetë kështu: pagat do të janë 7,619,000 euro, mallrat dhe shërbimet po ashtu të njëjta gjithashtu të njëjta edhe subvencionet kurse investimet kapitale do të rriten prej 4,562,000 euro, që do të thotë ndryshimi është te pozicionet dhe kategoritë e pagave dhe te investimet kapitale, pra këtu është reflektimi. Ne si ekzekutiv i komunës, KAB-in komunal pra pjesën teorike e kemi përgatitur si dokument por ne tash presim edhe vërejtjet tuaja apo ndonjë sugjerim. Kërkoi falje që kam lëshuar një gabim pasi sot e mora vesh që edhe qarkoren buxhetore me ju adresua juve por kam harruar edhe për këtë kërkoi falje. Dhe tash për mbledhjen e Kuvendit do ta kemi edhe qarkoren dhe ja vlen me lexua, diçka tjetër nuk kam për të thënë tani, pres ndonjë pyetje nga ana juaj.

**Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për prezantimin dhe paraqitjen e parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore ( KAB ).**

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkyetarin, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët edhe përfaqësuesit e mediave. Unë e falënderoj drejtorin për prezantimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021 – 2023. Drejtori ishte mjaf i qartë, unë desha me diskutua për disa gjëra ndoshta edhe më tepër për sqarime nga ana e drejtorit. Ne e kuptojmë se kjo është qarkorja e parë buxhetore edhe pritet më vonë edhe qarkorja e dytë edhe aty caktohen limitet ashtu siç duhet. Por, në parim siç thuhet edhe në dokument tani edhe KAB-in duhet ta miratojmë në mbledhjen e Kuvendit që do ta kemi për këtë muaj sepse siç e dimë është deri me 30 qershor afati i fundit për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore pra është 30 qershor sepse shpesh po ndodh që në shtator po ndodh miratimi i KAB-it, pra ne tani po e kryejmë dhe atëherë është krejt diçka tjetër, kështu që mos t'i ngatërrojmë gjërat. Ajo që unë desha me thënë që nuk e di tani drejtor pasi këtu po shkruan që në parim duhet me u miratua por ne si Kuvend kur të vjen dita me u miratua atëherë nuk e di se çka po miratojmë, për shkak se nuk kemi të shkruar asgjë faktikisht pra nuk kemi kurfarë shifra këtu, por ne po miratojmë një dokument boshë të thatë, që veç mjetet e përgjithshme që i cekët ju që janë caktua sa është totali i buxhetit pastaj sa është granti qeveritar, granti i përgjithshëm, granti i shëndetësisë, granti i arsimt mirëpo nëpër kategori ekonomike a është deshtë edhe në këtë qarkore ndoshta pak a shume me qenë disa propozime të shkruara aty pastaj ne qarkoren e dytë nuk na ndalon askush në bazë të zhvillimeve që bëhen naltë atje sigurisht prapë edhe ato me pësua ndryshimin këtu që duhet sepse e thash edhe me herët nëpër kategori ekonomike nuk kemi të dhëna kurfarë këtu se sa duhet për investime kapitale se paku në dokumentin që unë posedoij. Ndoshta do të ishte me mirë që edhe kur të miratojmë diçka me ditë se çka po miratojmë që me pas rezultate. Kjo është për tani, sigurisht që edhe ne mbledhje të Kuvendit do të kontribuojmë pak me tepër. Faleminderit!

**Fehmi Cena** – Në fakt, ne sot për këtë pikë të rendit të ditës nuk kemi shumë për të diskutuar, duke ditur që e kemi për të parën herë materialin për Kornizën Afatmesme Buxhetore. Drejtori e prezantoj shifrën e përgjithshme nga granti qeveritar që ka ardhë nga qarkorja buxhetore e parë, ku shihet edhe këtu në bazë të shënimëve se buxheti për vitin 2021 do të jetë me i vogël për 186,000 euro. Pyetja është se a është qartësuar kjo nga niveli qendor se pse është buxheti më pak për këtë vit, sepse ne jemi mësuar çdo herë për çdo vit me pas rritje, në fakt sa do e vogël apo e madhe, por ka qenë rritje, ndërsa tani kemi rënje edhe pse mendoj në krahësim me buxhetin e përgjithshëm nuk është ndonjë zbritje e madhe mirëpo megjithatë është zbritje

ndërsa ne kemi pritur që do të kemi më shumë buxhete. Kjo ndarje nga granti qeveritar është e qartë, në tabelë po i shohim edhe të hyrat vetanake që janë prezantuar sikurse edhe në vitin paraprak. Prandaj kemi shënimet e vitit 2020 që i kemi ditur edhe më përpara por për këto vitet e tjera nuk i kemi shënimet, besoj që në mbledhjen e Kuvendit do të kemi edhe shënimet e plota, pasi tash janë edhe ato dy variantet që i tha drejtori, nëse aplikohet ligji i pagave ose nëse jo, do të ketë ndryshime në ato dy pozicione d.m.th. në kategorinë për paga që ne të gjithë e presim me qenë ajo mirëpo pyetja është se a ka sinjale rrëth ligjt të pagave nga niveli qendror sepse megjithatë duhet të punohet sa më shpejt që ne të i kemi shifrat e sakta në mënyre që në mbledhjen e ardhshme të dimë se çka do të diskutojmë edhe çka do të aprovojmë. Faleminderit **Kryesuesi – Faleminderit** z. Cena, atëherë meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, drejtori me siguri ka edhe ndonjë sqarim.

**Afrim Limani** – Sipas ligjit të Financave Publike dhe Përgjegjësive e cila është e përcaktuar edhe ne qarkoren e parë buxhetore, ne duhet t'i aprovojmë vetëm pjesën kryesore të buxhetit, se sa është granti i përgjithshëm, granti i arsimit, granti i shëndetësisë dhe të hyrat vetanake. Pra, ne këto duhet të aprovojmë sepse ky buxhet ka rrjedhë nga formula e përgjithshme që e përcakton edhe buxhetin e organizatës tonë. Prandaj, për pjesën tjetër, pra kategoritë ekonomike e thash edhe më herët se ato i presim në qarkoren e dytë buxhetore dhe aty caktohen edhe limitet (tavanet) buxhetore se sa do të jetë buxheti sipas kategorive dhe për këtë e kemi mbledhjen e shtatorit ku duhet me u aprovua buxheti. Tash në parim qarkorja e parë buxhetore sipas ligjit duhet të aprovohet me këto pika buxhetore që i kemi si grantin qeveritar, të hyrat vetanake, granti i shëndetësisë dhe granti i arsimit edhe të hyrat vetanake që janë pikërisht të njëjtë në raport me vitin e kaluar sepse këto janë të përcaktuara nga Ministria e Financave. Për pjesën tjetër teorike të kategorive ekonomike, ne do ta diskutojmë edhe ne mbledhjen e shtatorit edhe sigurisht që do të japid mendime që po ashtu edhe pjesa e investimeve kapitale por tanë duhet ne parim të votohet qarkorja buxhetore apo KAB-i komunal me këto limite buxhetore të cilat janë të përcaktuara nga formula e përgjithshme në nivele qendrorë. Doktori e bëri një pyetje se pse do të jetë më i vogël, që edhe unë e kam bërë këtë pyetje mirëpo është në kuadër të Ministrisë se Financave është një departament i cili merret me politikat zhvillimore edhe sigurisht ata e përcaktojnë se sa do të jetë edhe rritja ekonomike e vendit në vitin 2021 edhe pikërisht këtu ka ndikuuar edhe pandemia Covid-19 që ka reflektuar edhe me parashikimin me te vogël të inkasimit të hyrave. Kjo ka reflektuar edhe nivele komunal diku në raport me vitin e kaluar ndryshimi është 6 milion, që ka reflektuar edhe në komunën tonë me një ndryshim prej 186,996 euro pra me një zbritje.

**Rasim Fazliu** - Buxheti që u përcaktua këtu pra limitet buxhetore a është në bazë të numrit të banorëve apo është ndonjë kriter tjetër për ndarjen e buxhetit për komuna në përgjithësi.

**Afrim Limani** – Formula është po e njëjta sikur me vitet e kaluara pra si kriter është numri i popullsisë sipërfaqja gjeografike pjesa e komunitetit edhe janë disa kritere tjera mirëpo për risi e thash edhe ne fillim se kërkoi falje se nuk ju kam dërguar edhe qarkoren buxhetore ne adresat e juaja. Pra aty ka një ndryshim te buxheti i arsimit ku i kemi futur disa kritere tjera që në mbledhjen e kuvendit ju do të shihni edhe cilat janë kriteret. Pra formula është po e njëjta sikur viteve tjera mirëpo tash zvogëlimi i nivelit qendror të buxhetit prej 6 milion edhe ka reflektua. E keni vërejt KAB-in komunal që ka shume faqe të zbrazëta ku krejt ato pjesë që reflektojnë në kuadër të këtij granti janë të plotësuara që kemi bërë edhe analiza të ndryshme në përqindje mirëpo ato që janë të zbrazura janë pjesa e kategorive ekonomike pra sa është pjesëmarrja e pagave, mallrave dhe shërbimeve, subvencioneve dhe investimeve kapitale, pra ato për mbledhjen e shtatorit do ti kemi.

**Kryesuesi – Faleminderit** shume drejtor, atëherë të nderuar kolegë konstatojmë se kalon për kuvendë edhe pika e dytë e rendit të ditës. Kalojm në pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi i Draft rregullores për taksa komunale.**

**Kryesuesi** – Te nderuar kolegë kuvendarë, i nderuar nënkyetar, drejtor dhe gjithë ju të pranishëm. Reth rregullores për taksa komunale në komunën tonë, grapi punues ka punuar jashtëzakonisht shume mbi dy javë që isha edhe vet prezantë dy herë dhe kam përcjellë punën e tyre dhe angazhimin ku kanë punuar edhe jashtë orarit që me muajt me harmonizua sa me mirë këtë rregullore. Gjithashtu Rregullorja ka kalua të gjitha procedurat tjera të debatit publik që ka pasur si dhe tash e kemi në kuvend dhe duhet të ju njoftoj siç edhe e dimë se me datën 16 të këtij muaji Kuvendi ka organizuar një punëtori për Rregulloren për taksa komunale

ku secili prej kuvendarëve pjesëmarrës aty që ishin kanë kanë dhënë kontributin e tyre dhe sot e kemi në Komitetin për Politika dhe Financa. Këtu në materialin fizik që e kemi, nuk i kemi të përmirësuara të cilat jemi dakorduar me datën 16 në punëtori por janë duke punuar nga Zyra Ligjore që të kryhen të gjitha sugjerimet e tona dhe për mbledhje të Kuvendit do ta kemi të kompletuar. Faleminderit shume

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, e falënderojmë edhe grupin punues që ka kryer një punë të mirë rrëth draft rregullores për taksa komunale. Edhe ju e cekët se ne kemi pasur një punëtori dhe në atë punëtori e kemi shqyrtuar mirë këtë Draft rregullore se paku jemi munduar dhe kemi dhanë kontributin tonë secili, kështu që tash veç kisha thënë që vetëm të del si rekomandim prej Komitetit për Politikë dhe Financa drejtuar Kuvendit që kjo Draft rregullore është trajtuar dhe i kemi dhënë vërejtjet tona edhe në mbledhje të Kuvendit që do ta kemi të radhës të miratohet.

**Fehmi Cena** – Edhe unë mendoj që ne delegatët e KPF-së që jemi sot prezantë dhe ishim prezantë në atë punëtori, e kemi shqyrtuar këtë çështje pra Rregulloren për taksa komunale edhe mendoj se kemi dhënë kontributin tonë kështu që nuk ka nevojë me humb sot për të diskutuar rrëth kësaj, e kalojmë për Kuvend dhe pastaj mendoj që edhe delegatet tjerë do të kenë mundësi të japid kontributin e tyre. Faleminderit!

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Cena, atëherë meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, konstatojmë se i rekomandohet edhe Kuvendit pika e tretë e rendit të ditës pra Draft rregullores për taksa komunale që të aprovohet. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

**4. Shqyrimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për faljen e borxheve për taksë komunale.** Siç edhe ju informova edhe me herët për shkak të mungesës së drejtorit për shkaqe shëndetësore, atëherë këtu e kemi zyrtarin nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillim që do të prezanton këtë pikë.

**Fidan Hoti** – Përshtështje kryesues, nënkyetar, delegatë dhe gjithë ju të pranishëm. Kuvendi Komunal ka marr vendim për faljen e borxheve në taksë dhe në objekte të dhëna në shfrytëzim nga komuna e Rahovecit. Pra është vendimi me numër 01/60, i datës 30.03.2020 ku janë liruar nga pagesat ne periudhën Mars- Maj të gjithë shfrytëzuesit e objekteve të pronës komunale dhe taksës komunale. Vlera e falur gjithë shfrytëzuesve të pronës komunale është 18,565 euro. Kjo natyrisht do të ndikoj edhe ne të hyrat e planifikuara që kemi planifikuar për vitin 2020, po ashtu vendimi është marr edhe për taksa komunale që vlerën e saktë nuk e di dhe për këtë kërkoi falje për periudhën mars-prill-maj mirëpo nëse ju intereson shkoj marr informata edhe ju sjelli. Faleminderit

**Kryesuesi** – Ne si Kuvend, si Komitet për Politikë dhe Financa e kemi tash këtë propozim që na ka ardhë mirëpo vendimin do ta marrim në mbledhje të Kuvendit dhe do t'i kemi sqarimet edhe më të hollësishme nga drejtori kur ta kemi prezant këtu. Faleminderit shumë!

**Rasim Fazliu** – Mendoj që ky propozim është i mirë, sepse ka qenë edhe prej disa kuvendarëve, kështu që ne mendojmë se është i mirë, se nuk është mirë Komuna e Rahovecit të ngarkohet me borxhe të cilat në fakt nuk janë borxhe sepse kemi të bëjmë me biznese të cilat nuk e ushtrojnë me veprimtarinë e tyre edhe tash figurojnë aty si borxhe që i kanë komunës së Rahovecit dhe Auditori i Përgjithshëm, po na jep vërejtje rrëth kësaj punë. Prandaj, unë mendoj se është mjaft e qëlluar që të gjitha bizneset të cilat nuk janë aktive dhe nuk e ushtrojnë veprimtarinë të ju falet ai borxh që është edhe të vazhdojmë më tutje. Faleminderit!

**Fehmi Cena** – Ne kemi të bëjmë me një propozim të Kryetarit të Komunës që të ju falet borxhi bizneseve të komunës tonë që kanë pasur veprimtari biznesi me përpëra dhe tash nuk ushtrojnë veprimtarinë, edhe për periudhën e caktuar kohore sikur që shkruan këtu 01.01.2000 deri me 30.12.2017, pra po i bie një periudhë goxha e gjatë kohore mbi 18 vite. Natyrisht që unë personalisht mendoj që ne jemi me i ndihmua bizneset e sidomos ato të cilat edhe nuk e ushtrojnë veprimtarinë, që me siguri i kanë pasur ato kushtet e vështira, dhe se Komuna duhet me ju dalë në ndihmë, mirëpo mendoj që për mbledhjen e Kuvendit duhet të kemi të dhënët më të saktë dhe të na jepet me saktë numri i atyre i bizneseve se sa do të jetë dhe shuma e përgjithshme në menyrë që me dit se sa do të jetë ajo shume që do të ju falet bizneseve, pra a do të jetë e madhe apo e vogël, ashtu sikurse u tha nga parafolësi i komunës që na prezantoj për atë vendimin që ne kemi marr në mbledhjen e marsit, që të ju falet bizneseve që kanë obligime për qera saktësish 19,996 euro, sigurisht duhet me ditë edhe për këtë më saktësish në menyrë që pastaj me dhanë secili mendimin sa më të arsyeshëm si kuvendarë. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Cena, gjithsesi bëhet fjalë edhe në propozim që bizneset të cilat janë shuar dhe nuk e ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe duhet të ndërmarrim diçka për shkak se nuk operojnë edhe është e pamundur me i mbledhë ato borxhe. Sido që të jetë për mbledhjen e Kuvendit do të kemi edhe numrin e saktë e atyre bizneseve edhe shumën e përgjithshme. Faleminderit shumë!


Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për Kuvend edhe pikë e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë e rendit të ditës:

**5. Të ndryshme.**

Atëherë meqë nuk kemi diçka, të nderuare kolegë, anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa, unë ju falënderoj shumë për kontributin e dhënë qhe mbledhjen e Kuvendit do ta kemi me datën 29 të këtij muaji, por meqë mua mu dha e drejta dhe mundësia me prezantua Rregulloren për taksë, ju stojë të gjithëve për kafe. Faleminderit shumë!

**Mbledhja përfundoj në 11:00**

Procesmbajtësi,

  
Agim Hoti

